



Nr. 227 Pr.  
dt. 14.12.2015

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 990, datë 9.12.2015

PËR

**DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.424,  
DATË 2.6.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN  
E RREGULLORES PËR SISTEMIN E AKREDITIMIT, ORGANIZIMIN  
DHE VEPRIMTARINË E INSTITUCIONEVE TË SIGURIMIT  
TË JASHTËM TË CILËSISË", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 60, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të neneve 138 e 142, të ligjit nr.80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në tekstin e rregullores për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë, të miratuar me vendimin nr.424, datë 2.6.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në nenin 5 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Në shërbim të politikave të arsimit të lartë ministria përgjegjëse për arsimin mund të kërkojë vlerësimin e jashtëm të cilësisë së institucioneve e të programeve të studimit nga agjenci të tjera vlerësimi, që janë anëtare me të drejta të plota të Rrjetit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) ose të Regjistrat Evropian të Agjencive të Sigurimit të Cilësisë (EQAR). Vlerësimi i jashtëm dhe konsulenca për kryerjen e këtij vlerësimi nga këto agjenci kryhet me qëllim akreditimin e programit/programeve të studimit apo të institucionit të arsimit të lartë.

standardet e procedurat vendase për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë.”.

b) Në fund të pikës 1, të nenit 5, shtohet pika 1.1, me këtë përmbajtje:

“1.1 Agjencia e huaj, pjesë e ENQA-s e EQAR-it, kontraktohet drejtpërdrejt nga ministria përgjegjëse për arsimin, në përputhje me tarifën e përcaktuara në këtë rregullore për vlerësim të jashtëm të cilësisë së programit/programeve të studimit apo të institucionit/institucioneve të arsimit të lartë dhe konsulencë për kryerjen e këtij vlerësimi.”.

2. Në nenin 9/1 bëhen ndryshimi dhe shtesat e mëposhtme:

a) Në pikën 1, fjalët “... tabelat nr.1 dhe nr.2, ...” zëvendësohen me “... tabelat nr.1.1 dhe tabela nr.2.1 ...”.

b) Pas pikës 2 shtohen pikat 3 dhe 4, me këtë përmbajtje:

“3. Pagesat për konsulencë për agjencitë e huaja të vlerësimit kryhen në bazë të tarifës ditore 700 euro/dita për çdo ekspert të huaj të angazhuar, por jo më shumë sesa 10 ditë pune për çdo ekspert të huaj. Ekspertëve të huaj të angazhuar nga agjencia e huaj e vlerësimit u mbulohen shpenzimet e udhëtimit e të qëndrimit në Republikën e Shqipërisë.

4. Pagesat për agjencitë e huaja të vlerësimit për akreditimin e programit/programeve të studimit apo të institucionit të arsimit të lartë bëhen mbështetur në pagesat mbi bazë eksperti, sipas pikës 2, të këtij neni, ku agjencia e huaj e vlerësimit mund të ketë shumicën e ekspertëve në grupet e vlerësimit. Ekspertëve të vlerësimit të angazhuar nga agjencia e huaj e vlerësimit u mbulohen shpenzimet e udhëtimit e të qëndrimit në Republikën e Shqipërisë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

**K R Y E M I N I S T R I**

**BDI RAMA**


MINISTRI I ARSIMIT  
DHE SPORTIT

LINDITA NIKOLLA

Në mungesë dhe porosi

ZËVENDËSMINISTRI

NORA MALAJ



NR.PROT.5625/3  
DATË 10.12. 2015

MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT  
MINISTRISË SË FINANCAVE  
MINISTRISË SË DREJTËSISË  
AGJENCISË PUBLIKE TË AKREDITIMIT TË  
ARSIMIT TË LARTË  
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

**Sekretari i Përgjithshëm**

**Engjell AGAÇI**



A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Engjell Agaçi', is written over a circular blue official stamp. The stamp contains the text 'REPUBLIKA E SHQIPËRISË' at the top and 'KESHILLI I MINISTRAVE' at the bottom, with a central emblem.